



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 01/77

Datë: 10.08.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 gusht 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti nga mbledhja e 76 e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/77

Datë: 10.08.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 45.1 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 gusht 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet Raporti gjashtëmujor i buxhetit për vitin 2009.
2. Ngarkohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që raportin nga pika 1 e këtij vendim t'ia procedojë për njoftim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Kuvendit të Republikës së Kosovës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/77

Datë: 10.08.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, si dhe nenit 20.1, dhe nenin 20.5, të Udhëzimit Administrativ nr. 03/2006 për Zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 gusht 2009, mori

V E N D I M

1. Emërohen anëtarët e Komisionit ndërinstitucional për vlerësimin e praktikave administrative në fushën e dokumenteve zyrtare, me këtë përbërje:

- | | |
|---------------------|--|
| 1. Arben Krasniqi | përfaqësues i Zyrës së Kryeministrit, kryetar; |
| 2. Shemsedin Mulla | përfaqësues i Kuvendit të Kosovës; |
| 3. Arben Loshi, | përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë; |
| 4. Liridon Dalipi, | përfaqësues i Komisioni të Pavarur për Media; |
| 5. Sylejman Gashi | përfaqësues i Ministrisë së Administratës Publike; |
| 6. Shkëmb Manaj, | përfaqësues i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve; |
| 7. Majlinda Ademaj, | përfaqësues i Ministrisë së Punëve të Brendshme; |
| 8. Hamit Shala, | përfaqësues i Arkivit të Kosovës. |


2. Detyrat e Komisioni ndërinstitucional janë:

- të këshillojë arkivistin dhe institucionet për çështjet që ndikojnë në lidhje me administrimin ose implementimin e Ligjit për Qasje në Dokumentet Zyrtare dhe Udhëzimit Administrativ nr. 03/2006 për Zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare;
- të konfirmojë, plotësojë, zëvendësojë ose të anulojë vendimet e arkivistit apo të institucionit në lidhje me implementimin e Ligjit për Qasje në Dokumentet

Zyrtare apo të Udhëzimit Administrativ nr. 03/2006 për Zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare;

- të vendosë në lidhje me parashtrirat që i referohen këtij komisioni.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/77

Datë: 10.08.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, si dhe Strategjisë së Reformës së Administratës Publike, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 gusht 2009, mori,

V E N D I M

1. Miratohet plotësimi dhe ndryshimi i Planit të Veprimit për zbatimin e Reformës së Administratës Publike.
2. Për zbatimin e Planit të Veprimit sipas pikës 1. të këtij vendimi, ngarkohen të gjitha institucionet qeveritare të Republikës së Kosovës.
3. Për koordinimin, monitorimin dhe raportimin mbi progresin e zbatimit të Planit të Veprimit, ngarkohet Ministria e Administratës Publike.
4. Obligohen të gjitha institucionet qeveritare të Republikës së Kosovës për bashkëpunim me Ministrinë e Administratës Publike për realizimin e këtij plani të veprimit.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit


Hasim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/77
Datë: 10.08.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 gusht 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet Plani Zhvillimor Strategjik 2009 - 2013 i Entit Statistikor të Kosovës.
2. Ngarkohet Ministria e Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/77
Datë: 10.08.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10.08.2009, mori

V E N D I M

1. Themelohet Njësia për Planifikim Strategjik.
2. Njësia për Planifikim Strategjik do të funksionojë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.
3. Njësia përbëhet nga koordinatori dhe katër (4) zyrtarë, të cilët do të punojnë në bazë të detyrave dhe përgjegjësive të përcaktuara nga Zyra e Kryeministrit.
4. Të punësuarit në këtë njësi do të jenë nëpunës civilë dhe pagesa e tyre do të përcaktohet sipas Vendimit të Qeverisë së Kosovës Nr. 07/63, të datës 07.05.2009.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/77
Datë: 10.08.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 gusht 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet Projektligji për Turizmin dhe Shërbimet Turistike.
2. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/77

Datë: 10.08.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 34.20 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/17 për Prokurim Publik të Ndryshuar me Ligjin Nr. 02/L-99, si dhe të nenit 4, paragrafi 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10.08. 2009, mori:

V E N D I M
PËR BLERJEN E OBJEKTEVE PËR AMBASADA TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS

1. Blerja e objekteve bëhet në këto shtete pranuese, ku janë të akredituara Ambasadat e Republikës së Kosovës: Uashington (SHBA), Londër (Mbretëri e Bashkuar), Bruksel (Belgjikë), Paris (Francë).
2. Në rast se mbesin mjete të mjaftueshme financiare brenda buxhetit të lejuar për blerjen e objekteve të Ambasadave të cekura në paragrafin 1. lejohet edhe blerja e objekteve për Ambasada në vende tjera.
3. Ngarkohet Zyra e Kryeministrit, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Ministria e Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr.09 /77
Datë: 10.08.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 gusht 2008, mori:

V E N D I M

1. Familjeve Aliu dhe Ahmeti nga fshati Suhodoll i komunës së Mitrovicës, me rastin e vdekjes tragjike të tre fëmijëve të tyre, Qeveria e Republikës së Kosovës iu ndanë mjete financiare në vlerë prej 10.000 (dhjetëmijë) euro, për ndihmë në rindërtimin e shtëpisë të familjarit Gëzim Aliu, si dhe 10.000 (dhjetëmijë) euro për mbulimin e shpenzimeve të ceremonisë mortore për familjarët; Sadri Aliu 5.000 (pesëmijë) euro dhe Zaim Ahmeti 5.000 (pesëmijë) euro.
2. Mjetet financiare sipas pikës 1. të këtij vendimi ndahen nga shpenzimet e paparashikuara të Qeverisë dhe atë si vijon: 10.000 (dhjetëmijë) euro nga kategoria ekonomike shpenzime kapitale dhe barten në Kuvendin Komunal të Mitrovicës, kodi organizativ 642, kodi i programit 660, kategoria ekonomike shpenzime kapitale, ndërsa, 10.000 (dhjetëmijë) euro nga kategoria ekonomike rezerva, dhe barten në kodin organizativ 640, kodi i programit 730, kategoria ekonomike subvencione.
3. Obligohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Kuvendi Komunal i Mitrovicës për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 10/77

Datë: 10.08.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 gusht 2009, mori

V E N D I M

1. Ndahen mjetet financiare në vlerë prej 120.000 (njëqindnjëzet mijë) euro për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në infrastrukturë dhe në kulturat bujqësore në Komunën e Suharekës.
2. Mjetet financiare sipas pikës 1. të këtij vendimi ndahen nga shpenzimet e paparashikuara të Qeverisë, kategoria ekonomike shpenzime kapitale dhe barten në Kuvendin Komunal të Suharekës, kodi organizativ 624, kodi i programit 180, kategoria ekonomike subvencione.
3. Obligohet Kuvendi Komunal i Suharekës të autorizojë komisionin komunal për vlerësimin e dëmeve në infrastrukturë të shkaktuara nga vërshimet, për të përcaktuar prioritetet sipas sektorëve dhe kategorive si dhe përpilimin e listës së përfituesve potencialë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Kuvendi Komunal i Suharekës.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë